17	W000001720	0.39	84	LFT20100N	0.85	151	LFT20100N	0.82
18	NHT3096	1	85	LFT20100N	0.84	152	W000006531	1
19	W000006068	0.05	86	W000006531	1	153	W000004271	1
20	W000001724	0.05	87	NHS17882	1	154	NHVG7529	1
21	NHT3187	1	88	LFT20100N	0.77	155	NHG15762	1
22	W000006115	0.05	89	LFT20100N	0.79	156	LFT20075N	0.74
23	W000004481	0.05	90	W000006531	1	157	1450055200	1
24	SLVRI48022703 030C	1	91	NHS17884	1	158	7150012800	1
25	NHRO443	1	92	LFT20100N	1.98	159	NHG18381	1
26	NHS10960	1	93	LFT20100N	1.95	160	LFT20075N	0.2
27	1450074600	1	94	LFT20100N	1.9	161	LFT20075N	0.22
28	LFT20075Z	2.91	95	W000006531	1	162	1450075000	1
29	LFT20075Z	2.93	96	NHS17889	1	163	7150012900	1
30	LFT20075Z	2.92	97	LFT20100N	0.64	164	NHS14785	1
31	NHS13388	1	98	W000006531	1	165	LFT20075N	0.21
32	1450074600	1	99	NHS17890	1	166	W000000663	1
33	LFT20075Z	1.23	100	LFT20100N	1.74	167	NHS14786	1
34	NHT1981	1	101	LFT20100N	1.74	168	LFT20075N	0.7
35	3971016600	0.33	102	W000006531	1	169	1450074600	1
36	NHT1982	1	103	NHS17892	1	170	NHS14788	1
37	3971016600	0.27	104	LFT20100N	1.98	171	LFT20075N	0.21
38	1450074600	1	105	LFT20100N	1.97	172	1400397300	1
39	NHRO576A	1	106	W000006531	1	173	NHS17877	1
40	NHRO576	1	107	W000004272	1	174	LFT20100N	0.55
41	NHS17885	1	108	NHVG7525	1	175	W000006531	1
42	LFT20075N	1.66	109	NHG12540	1	176	NHS17883	1
43	1400428700	1	110	1450072000	1	177	LFT20100N	0.4
44	NHS17888	1	111	7150012900	1	178	W000006531	1
45	LFT20075N	1.63	112	LFT20075N	1.47	179	NHS17887	1
46	LFT20075N	1.59	113	NHG12543	1	180	LFT20100N	0.21
47	W000000075	1	114	1450055200	1	181	W000006531	1
48	NHS17893	1	115	LFT20075N	1.16	182	NHS17891	1
49	LFT20075N	0.41	116	1400396300	1	183	LFT20100N	0.49
50	1400152700	1	117	7150012800	1	184	W000006531	1
51	NHVG7523	1	118	NHG14570	1	185	NHS17915	1
52	NHG15774	1	119	1400396300	1	186	LFT20250N	1.32
53	LFT20075N	1.73	120	7150012800	1	187	LFT20250N	1.31
54	1450075000	1	121	LFT20075N	0.51	188	W000004271	1
55	7150012900	1	122	NHG18374	1	189	1400464200	1
56	NHG18373	1	123	LFT20075N	0.51	190	W000004286	1
57	LFT20075N	0.75	124	1400396300	1	191	NHVG5333	1
58	LFT20075N	0.76	125	7150012800	1	192	NHS10934	1
59	1450072000	1	126	NHG18380	1	193	1400396400	1
60	7150012900	1	127	LFT20075N	0.51	194	LFT20100B	0.23
61	NHS14790	1	128	1400396300	1	195	NHS10935	1
62	LFT20075N	1.73	129	7150012800	1	196	1400152700	1
63	1400397300	1	130	NHG18382	1	197	LFT20075B	0.2
64	NHS14792	1	131	LFT20050N	0.51	198	NHS10936	1
65	LFT20075N	0.73	132	1400404600	1	199	1400152700	1
66	1450074600	1	133	7150012800	1	200	LFT20075B	0.2
67	NHS15210	1	134	NHS13353	1	201	W000004270	1

Nr.	Nr. Ref. ose Kodi	Sasia	Nr.	Nr. Ref. ose Kodi	Sasia	Nr.	Nr. Ref. ose Kodi	Sasia
202	NHZG6068	1	269	7150012900	1	336	LFT20075Z	0.86
203	NHS10949	1	270	NHS14801	1	337	1400396300	1
204	W000000075	1	271	LFT20150Z	0.34	338	7150012800	1
205	LFT20075V	0.14	272	1400396400	1	339	NHG18379	1
206	NHS10951	1	273	W000004270	1	340	LFT20075Z	0.86
207	1400397300	1	274	NHZG6693	1	341	LFT20075Z	0.86
208	LFT20075V	0.7	275	NHG15781	1	342	1400396300	1
209	NHS13382	1	276	LFT20075Z	1.06	343	7150012800	1
210	1400397300	1	277	LFT20075Z	1.08	344	NHS17908	1
211	LFT20075V	3.9	278	1450075000	1	345	LFT20100Z	0.45
212	LFT20075V	3.92	279	7150012900	1	346	W000006531	1
213	W000004270	1	280	NHG15782	1	347	NHS17909	1
214	NHZG6073	1	281	LFT20075Z	2.85	348	LFT20100Z	1.42
215	NHS10955	1	282	LFT20075Z	2.88	349	LFT20100Z	1.44
216	1400152700	1	283	1450075000	1	350	W000006531	1
217	LFT20075B	0.3	284	7150012900	1	351	NHS17910	1
218	LFT20075B	0.29	285	NHS14802	1	352	LFT20400Z	0.74
219	NHS13384	1	286	LFT20150Z	0.4	353	LFT20400Z	0.73
220	LFT20075B	1.17	287	LFT20150Z	0.39	354	1450071100	1
221	1400397300	1	288	1400396400	1	355	NHS17911	1
222	LFT20075B	1.19	289	W000004270	1	356	LFT20100Z	0.56
223	NHS13385	1	290	NHZG7521	1	357	W000006531	1
224	1400397300	1	291	NHG12552	1	358	NHS17912	1
225	LFT20075B	2.96	292	1450072000	1	359	LFT20100Z	1.56
226	W000004270	1	293	7150012900	1	360	LFT20100Z	1.58
227	NHZG6074	1	294	LFT20075R	0.68	361	W000006531	1
228	NHG12546	1	295	NHS14796	1	362	W000004271	1
229	1450072000	1	296	LFT20075R	0.33	363	NHZG7526	1
230	7150012900	1	297	1450071800	1	364	NHS10976	1
231	1400396300	1	298	NHS17906	1	365	1400152700	1
232	7150012800	1	299	LFT20100R	2.4	366	LFT20075R	0.14
233	LFT20075Z	0.36	300	LFT20100R	2.41	367	NHS10977	1
234	NHG12547	1	301	1400396400	1	368	LFT20075R	0.14
235	1450072000	1	302	W000004270	1	369	1400152700	1
236	7150012900	1	303	NHZG7522	1	370	NHS17907	1
237	LFT20075Z	0.96	304	NHS17899	1	371	LFT20100R	0.29
238	NHS10926	1	305	LFT20100Z	2.87	372	1450070900	1
239	W000000063	1	306	LFT20100Z	2.89	373	W000004270	1
240	LFT20075Z	2.35	307	W000006531	1	374	NHZG7527A	1
241	NHS13369	1	308	NHS17900	1	375	NHZG7527	1
242	1400152700	1	309	LFT20100Z	2.95	376	NHS17894	1
243	LFT20075Z	0.9	310	W000006531	1	377	LFT20200R	0.32
244	W000004270	1	311	NHS17901	1	378	1450070900	1
245	NHZG6687	1	312	LFT20100Z	1.62	379	NHS17895	1
246	NHS10945	1	313	W000006531	1	380	LFT20100R	0.08
247	LFT20075R	0.34	314	NHS17902	1	381	LFT20100R	0.11
248	1400152700	1	315	LFT20100Z	1.56	382	1400396400	1
249	LFT20075R	0.31	316	W000006531	1	383	NHS17896	1
250	NHS13379	1	317	NHS17903	1	384	LFT20100R	0.08
251	1400428700	1	318	LFT20100Z	1.5	385	LFT20100R	0.11
252	LFT20075R	1.56	319	W000006531	1	386	1450070900	1
253	LFT20075R	1.55	320	NHS17904	1	387	W000004270	1
254	NHS14799	1	321	LFT20400Z	1.93	388	NHZG7928	1
255	LFT20075N	0.08	322	LFT20400Z	1.96	389	NHS10971	1
256	LFT20075R	0.11	323	LFT20400Z	1.94	390	1450074600	1
257	1400152700	1	324	1450071100	1	391	LFT20075Z	1.69
258	W000004270	1	325	NHS17905	1	392	NHS13394	1
259	NHZG6692	1	326	LFT20100Z	2.8	393	1400152700	1
260	NHG15779	1	327	LFT20100Z	2.82	394	LFT20075Z	0.66
261	LFT20075Z	1.11	328	W000006531	1	395	LFT20075Z	0.65
262	LFT20075Z	1.13	329	W000004271	1	396	NHS15224	1
263	1450075000	1	330	NHZG7524	1	397	LFT20075Z	0.7
264	7150012900	1	331	NHG18375	1	398	1450074600	1
265	NHG15780	1	332	LFT20100Z	0.86	399	LFT20075Z	0.72
266	LFT20075Z	2.9	333	1400396300	1	400	W000004270	1
267	LFT20075Z	2.93	334	7150012800	1	401	NHZG9965	1
268	1450075000	1	335	NHG18378	1	402	NHS10921	1

Nr.	Nr. Ref. ose Kodi	Sasia	Nr.	Nr. Ref. ose Kodi	Sasia	Nr.	Nr. Ref. ose Kodi	Sasia
403	1450074600	1	470	7150012800	1	537	NHS13386	1
404	LFT20075Z	0.59	471	1400152700	1	538	1400152700	1
405	NHS10922	1	472	NHG18376	1	539	W000000063	1
406	1400428700	1	473	LFT20100Z	1.48	540	LFT20075Z	1.47
407	LFT20100Z	0.57	474	LFT20100Z	1.5	541	LFT20075Z	1.45
408	NHS10924	1	475	1400396300	1	542	NHS13387	1
409	W000000063	1	476	7150012800	1	543	W000000063	1
410	LFT20075Z	0.38	477	W000006531	1	544	1400152700	1
411	NHG18384	1	478	NHG18377	1	545	LFT20075Z	3.23
412	LFT20075Z	1.26	479	LFT20100Z	2.44	546	LFT20075Z	3.22
413	LFT20075Z	1.24	480	LFT20100Z	2.47	547	NHS13389	1
414	1400396300	1	481	1400396300	1	548	LFT20075C	1.66
415	7150012800	1	482	7150012800	1	549	LFT20075C	1.65
416	NHG18383	1	483	W000006531	1	550	1400428700	1
417	LFT20075Z	1.26	484	NHG18385	1	551	1400152700	1
418	LFT20075Z	1.24	485	LFT20100Z	0.47	552	LFT20075C	1.68
419	1400396300	1	486	1400396300	1	553	NHS13390	1
420	7150012800	1	487	7150012800	1	554	1450074600	1
421	NHS14804	1	488	1400396400	1	555	1400428700	1
422	LFT20100Z	1.11	489	NHG18387	1	556	LFT20075B	1.63
423	LFT20100Z	1.1	490	LFT20075B	0.47	557	LFT20075B	1.62
424	1400396400	1	491	1400152700	1	558	NHS13391	1
425	NHG24754	1	492	1400396300	1	559	1450074600	1
426	LFT20075Z	1.26	493	7150012800	1	560	1400428700	1
427	LFT20075Z	1.24	494	NHG18388	1	561	LFT20075H	1.63
428	1400396300	1	495	LFT20100C	0.47	562	LFT20075H	1.62
429	7150012800	1	496	1400396300	1	563	NHS13392	1
430	W000004270	1	497	7150012800	1	564	1450074600	1
431	SLVTA48022703 030C	1	498	1400396400	1	565	1400428700	1
432	NHG14578	1	499	NHS10930	1	566	LFT20075B	3.08
433	1450072000	1	500	1400152700	1	567	NHS13393	1
434	7150012900	1	501	1400152700	1	568	1450074600	1
435	1450074600	1	502	LFT20075B	0.4	569	1400428700	1
436	LFT20075Z	0.89	503	LFT20075B	0.42	570	LFT20075H	3.08
437	NHG15757	1	504	NHS10931	1	571	NHS17897	1
438	LFT20075B	2.06	505	1400152700	1	572	LFT20100Z	3.32
439	1450055200	1	506	1400152700	1	573	LFT20100Z	3.33
440	7150012800	1	507	LFT20075B	0.4	574	W000006531	1
441	1400152700	1	508	LFT20075B	0.42	575	1400396400	1
442	NHG15758	1	509	NHS10952	1	576	NHS17898	1
443	LFT20075L	2.04	510	W000000075	1	577	LFT20100Z	1.55
444	LFT20075L	2.06	511	1400397300	1	578	LFT20100Z	1.54
445	1400152700	1	512	LFT20075C	0.8	579	1450070900	1
446	1450055200	1	513	NHS10953	1	580	W000006531	1
447	7150012800	1	514	W000000075	1	581	NHS17913	1
448	NHG15763	1	515	1400397300	1	582	LFT20100C	0.42
449	LFT20075L	2.04	516	LFT20075G	0.8	583	1450074600	1
450	LFT20075L	2.06	517	NHS10969	1	584	1400428700	1
451	1400152700	1	518	1400396400	1	585	NHS17914	1
452	1450071900	1	519	1450070900	1	586	LFT20075C	1.61
453	1450055200	1	520	LFT20100R	0.4	587	LFT20075C	1.63
454	7150012800	1	521	LFT20100R	0.42	588	LFT20075C	1.62
455	NHG15764	1	522	NHS10983	1	589	W000000075	1
456	LFT20100C	2.06	523	LFT20100B	0.4	590	1400152700	1
457	1450055200	1	524	LFT20100B	0.42	591	NHS17916	1
458	7150012800	1	525	1400396400	1	592	LFT20075Z	0.41
459	1400396400	1	526	1450070900	1	593	LFT20075Z	0.42
460	NHG15765	1	527	NHS13380	1	594	1450071900	1
461	LFT20075C	1.51	528	1400397300	1	595	1400152700	1
462	LFT20075C	1.53	529	LFT20075C	4	596	NHS17917	1
463	1450055200	1	530	LFT20075C	4.02	597	LFT20075Z	0.41
464	7150012800	1	531	W000000075	1	598	LFT20075Z	0.42
465	1400152700	1	532	NHS13381	1	599	1400152700	1
466	NHG15766	1	533	1400397300	1	600	1400152700	1
467	LFT20075B	1.51	534	LFT20075G	4	601	LFT20050N	0.49
468	LFT20075B	1.53	535	LFT20075G	4.02	602	LFT20075B	13.91
469	1450055200	1	536	W000000075	1	603	LFT20075C	9.36

Nr.	Nr. Ref. ose Kodi	Sasia	Nr.	Nr. Ref. ose Kodi	Sasia	Nr.	Nr. Ref. ose Kodi	Sasia
604	LFT20075G	4.72	671	1310064100	1	738	W000006501	1
605	LFT20075H	4.64	672	7150009200	3	739	W000006505	1
606	LFT20075L	4.01	673	1350091100	1	740	6910403000	1
607	LFT20075N	18.16	674	1350089200	1	741	1350074700	1
608	LFT20075R	3.09	675	1900175100	1	742	6970051000	1
609	LFT20075V	4.64	676	1900175000	1	743	7150009200	1
610	LFT20075Z	31.7	677	W000000065	1	744	1350091100	1
611	LFT20100B	0.55	678	W000006501	1	745	1310064100	1
612	LFT20100C	2.81	679	W000006505	1	746	7150009200	2
613	LFT20100N	13.89	680	W000006501	1	747	W000004286	1
614	LFT20100R	3.08	681	W000006505	1	748	1400464200	1
615	LFT20100Z	28.55	682	6910403000	1	749	1350061800	1
616	LFT20150Z	0.69	683	W000006501	1	750	1350061800	1
617	LFT20200R	0.31	684	W000006505	1	751		
618	LFT20250N	3.12	685	6910403000	1	752		
619	LFT20400Z	2.6	686	W000006501	1	753		
620	M000003440	7	687	W000006505	1	754		
621	4970012500	0.2	688	6910403000	1	755		
622	6912024900	2	689	M1052166	1	756		
623	6970048100	2	690	W000000073	1	757		
624	M000000051	2	691	W000000074	1	758		
625	7150012800	23	692	1350090200	1	759		
626	7150012900	12	693	6970049700	7	760		
627	M1490546	1	694	6970055900	1	761		
628	W000002041	1	695	7145058100	1	762		
629	W000005081	1	696	M1052166	1	763		
630	W000006204	1	697	1350089200	1	764		
631	7105299400	14	698	W000006501	1	765		
632	4000203000	3	699	W000006505	1	766		
633	4970010300	45.81	700	6910403000	1	767		
634	4970011200	0.2	701	W000006501	1	768		
635	4970011600	0.96	702	W000006505	1	769		
636	6913017500	2	703	6910403000	1	770		
637	W000004270	12	704	W000006501	1	771		
638	W000004271	4	705	W000006505	1	772		
639	W000004272	1	706	6910403000	1	773		
640	9000040100	1	707	1350089200	1	774		
641	W000000063	6	708	1350055700	1	775		
642	W000000075	7	709	1310066400	1	776		
643	W000006531	28	710	6918273500	1	777		
644	1400152700	27	711	7150009200	1	778		
645	1400396300	14	712	1350055700	1	779		
646	1400396400	12	713	1350089200	1	780		
647	1400397300	10	714	W000006501	1	781		
648	1400404600	1	715	W000006505	1	782		
649	1400428700	9	716	6910403000	1	783		
650	1450055200	8	717	W000006501	1	784		
651	1450070900	6	718	W000006505	1	785		
652	1450071100	2	719	6910403000	1	786		
653	1450071800	1	720	W000006501	1	787		
654	1450071900	1	721	W000006505	1	788		
655	1450074600	16	722	6910403000	1	789		
656	1450075000	12	723	1350089200	1	790		
657	3971016600	0.66	724	1350091100	1	791		
658	W000006061	2.03	725	1350091100	1	792		
659	W000001720	2.03	726	1350086900	1	793		
660	W000006062	0.1	727	1350089200	1	794		
661	W000001721	0.1	728	1350055700	1	795		
662	W000006063	0.05	729	W000000065	1	796		
663	W000001723	0.05	730	W000006501	1	797		
664	W000006068	0.05	731	W000006505	1	798		
665	W000001724	0.05	732	W000006501	1	799		
666	4069012700	0.11	733	W000006505	1	800		
667	M000002059	3.15	734	6910403000	1	801		
668	W000002586	1	735	W000006501	1	802		
669	W000002810	1	736	W000006505	1	803		
670	6970049700	3	737	6910403000	1	804		

1.10 Aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit (si ndërtimi i kampeve apo rezidencave)

Zhvillimi i aktivitetit nuk parashikohet të kërkojë aktivitete të tjerë shtesë.

1.11 Informacion për lejet, autorizimet dhe liçencat e nevojshme për projektin

Bazuar në kërkesat e legjislacionit në fuqi, përpara zbatimit, aktiviteti duhet të marrë aprovimin mjedisor, i cili sigurohet përmes Deklaratës Mjedisore ndjekur nga Leja e mjedisit. Gjithashtu, shoqëria do të nisë procedurat për marrjen e lejes për përdorimin e ujit të pusit.

1.12 Kopje të lejeve, autorizimeve dhe liçencave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar

Shoqëria investitore është e legjitimuar për zhvillimin e këtij aktiviteti (sipas ekstraktit të QKR, bashkëlidhur). Aktualisht ajo zotëron vetëm qiranë për marrjen në përdorim të instalimit (kopje bashkëlidhur në Shtojcën 3 të këtij raporti).

2 PËRSHKRIMI I MJEDISIT NË ZONËN E PROJEKTIT

2.1 Përshkrim i shkurtër i mbulesës bimore të zonës ku gjendet instalimi

Instalimi i marrë me qira në të cilin synohet të zhvillohet aktiviteti gjenden në një zonë urbane dhe kjo vërehet edhe nga harta e mbulimit të tokës sipas sistemit Corine 2018 (Figura 10). Ai kufizohet nga tre anë të tij me ndërtesa banimi dhe shërbimesh dhe vetëm në kufirin verior kufizohet nga toka bujqësore jo të punuara.




Figura 10: Mbulesa e sipërfaqes së tokës në zonën ku gjendet instalimi sipas sistemit Corine

2.2 Trupat ujorë në zonën e aktivitetit

2.2.1 Ujërat sipërfaqësorë

Trupat më të afërt ujorë me instalimin janë lumi i Tërkuzës i cili rrjedh rreth 800 m në veri të tij dhe disa rezervuarë të vegjël të krijuar nga mbishfrytëzimi i shtratit të lumit për inerte, të cilët gjenden rreth 550-600 m gjithashtu në veri të instalimit. (Figura 11)

Lumi i Tërkuzës, i cili rrjedh në verilindje të zonës në studim, ka një gjatësi rreth 36 km. Ai buron në pjesën veriperendimore të Malit me Gropa dhe pasi përshkon depozitimet karbonatike e terrigjene të zonës së Bastarit, Vilzës e Bulçeshit, ndërpret formacionet e vargmalit Krugë-Dajt në zonën e Bovillës, duke krijuar një luginë të thellë me shpate të thepisura. Pasi zbrit në zonën e Zall-Herrit, rrjedh nëpër depresionin Tiranë – Ishëm, drejt fushës së Kamzës deri në afërsi të Fushë Prezës ku bashkohet me lumin e Tiranës duke formuar lumin e Ishmit, i cili derdhet në detin Adriatik, në gjirin e Rodonit.

Nga studimet e kryera rezultojnë se në inertet e këtij lumi predominojnë zaret gëlqerore dhe ato ranore duke qenë se gjatë rrjedhës ai ndërpret kryesisht formacione sedimentare, karbonatike dhe terrigjene dhe shumë pak magmatikë. Përpara ndërimit të rezervuarit të Bovillës, shtimi i rrjedhës së lumit gjatë stinës së dimrit dhe pranverës shkaktonte përmbajtje të shumta. Me ngritjen e rezervuarit të Bovillës dhe disiplinimin e shtratit me prita e argjinatura, ujrata e lumit të Tërkuzës janë shfrytëzuar dhe shfrytëzohen për furnizimin me ujë të qytetit të Tiranës.



Figura 11: Trupat ujorë në afërsi të instalimit

2.2.2 Ujërat nëntokësorë

Zona në të cilën gjenden instalimi përfshihet në pellgun Tiranë-Ishëm i cili përbëhet nga zhavorre relativisht të pasura me ujra nëntokësorë. Vetitë filtruese të zhavorreve janë relativisht të mira. Ato lëkunden nga 30-50m/ditë në jug (Valias-Fushë Krugë) deri në 5-10m/ditë në pjesën veriore të pellgut ku sasia e rërës rritet. Prurjet specifike të puseve përputhen sipas ligjesisë së vetive filtruese nga 7l/s/m në jug të pellgut deri në 1l/s/m në veriperëndim. Nga ky pellg ujëmbajtës merren mbi 500l/s dhe konsiderohet si pellgu me shfrytëzim më intensiv. Vetitë fiziko-kimike të ujrave të këtij pellgu janë të

mira me $M_p=0.5-0.8\text{mg/l}$ deri në afërsi të lumit të Drojës, ndërsa në afërsi të Fushës së Ishmit dhe deri në brezin bregdetar ata kripëzohen deri në 3mg/l . Nga analizat e kryera rezultojnë se janë ujëra neutrale, jo agresive ndaj hekurit dhe betonit.

2.3 Gjeomorfologjia dhe tokat

Nga pikpamja fiziko-gjeografike zona në të cilën ndodhet instalimi ku propozohet të zhvillohet aktiviteti shtrihet në Njësinë e Fushave midis Lezhës, Tiranës dhe Durrësit të Ultësirës Perëndimore. Rajoni përbëhet nga një radhë kodrash me drejtim veriperëndim-juglindje, të cilat shtrihen nga gryka e Skoranës në juglindje e deri në rrjedhën e përroit të Zezës në veriperëndim. Në perëndim ulet mbi Fushën e Tiranës kurse në lindje kufizohet nga vargu Priskë-Dajt. Në zhvillimin e relievit ka ndikuar mjaft edhe prania e një rrjeti të dendur përrenjsh të tipit subsekuent, i cili duke e ndërprerë tërthor vargun, e ka ndarë në një radhë kodrash të veçuara. Ndër luginat më të rëndësishme janë ato të lumit të Zezës, Tërkuzës dhe në anën perëndimore ajo e lumit të Tiranës, të cilat karakterizohen nga një sërë ngushtimesh e zgjerimesh. Në të tre luginat dallohen deri në dy nivele taracash. Instalimi gjendet mbi një tarracë të vjetër të lumit të Tërkuzës, me kuotë rreth 80 m mbi nivelin e detit.

Tokat në zonën ku ndodhet instalimi janë Toka Livadhore Aluvionale. Këto toka përgjithësisht gjenden përgjatë rrjedhjes së poshtme të lumenjve (zona gjendet në rrjedhën e poshtme të lumit Tërkuzë). Këto toka janë formuar në depozitime lumore, mbi të cilat faktorët zonalë kanë vepruar për një kohë të shkurtër. Për këtë arsye janë toka me një stad krahasimisht të ulët zhvillimi.

2.4 Gjeologjia dhe sizmiteti

Rajoni ku ndodhet zona e instalimit shtrihet në pjesën perëndimore të sinklinalit të Tiranës, i cili shtrihet në sektorin lindor të Ultësirës Pranadriatike. Sinklinali i Tiranës ka një formë të zgjatur me shtrirje verilindje-jugperëndim dhe vendoset ndërmjet dy strukturave pozitive, asaj të Dajtit në lindje dhe monoklinalit të Prezës në perëndim. Ai ka pjerrësi të vogël në drejtim të veriperëndimit dhe në thellësi ka ndërtim asimetrik të kondicionuar nga mbihypja e monoklinalit të Prezës. Në këtë sinklinal takohet një rrjet i zhvilluar hidrografik i përfaqësuar nga lumi i Tiranës dhe ai i Tërkuzës, të cilët kanë luajtur rolin kryesor në mbushjen e fushës së Tiranës me sedimente të reja.

Zona ku gjendet instalimi përfaqëson një rrafshinë me rënie të lehtë në drejtim të veriperëndimit, formuar nga mbushja me depozitime aluviale të strukturës sinklinale në fund të Neogjenit dhe fillim të Pleistocenit.

Në bazë të rajonizimit sizmik të sipërfaqes së Shqipërisë zona e studimit tonë përfshihet në zonën sizmike me intensitet 7 ballë, sipas shkallës MKS (viti 1964) dhe magnitudë 6.5-7 për kushte mesatare trualli.

2.5 Klima dhe cilësia e ajrit

Zona në studim bën pjesë në nënzonën klimatike fushore qendrore perëndimore ku mbizotëron klima mesdhetare fushore me dimër të butë dhe tepër të lagët dhe verë të nxehtë e tepër të thatë. Treguesit e elementëve klimatikë janë thuajse të njëjtë me pjesët e tjera të Ultësirës Perëndimore, me ndryshime të papërfillshme.

Temperaturat në zonën në studim janë relativisht të larta. Temperatura mesatare vjetore luhetet në intervalin 15 -16°C dhe në këto vlera luan një rol të rëndësishëm briza detare e cila ndihet në të gjithë zonën. Muaji më i ftohtë i vitit është janari me temperaturë mesatare 5°C, por ditë të ftohta vërehen edhe gjatë vjeshtës apo fillimit të pranverës. Muajt më të nxehtë të vitit janë korriku dhe gushti me temperaturë mesatare 24°C. Vlerat skajore të temperaturës luhaten në kufij mjaft të mëdhenj nga – 8°C/- 9°C (minimumi absolut) në 40°C/41°C (maksimumi absolut). Zona dallohet për vlera të larta të diellëzimit: shuma vjetore e orëve me ndriçim diellor arrin 2600 orë. Mesatarisht në periudhën dhjetor – mars mund të shfaqen ngricat që zakonisht zgjatin pak, rrallëherë gjatë gjithë ditës.

Sasia mesatare vjetore e reshjeve ndryshon nga 1241 mm në 1354 mm. Kjo vlerë është më e vogël se mesatarja e gjithë vendit, por gjithsesi ajo mbetet një sasi e madhe që siguron sasira të konsiderueshme uji. Çdo vit takohen mesatarisht 120-130 ditë me reshje të përqëndruara, zakonisht gjatë gjysmës së ftohtë të vitit. Shpërndarja vjetore e tyre është e çrregullt, tipike kjo për regjimin mesdhetar.

Gjatë gjysmës së ftohtë të vitit mbizotërojnë erërat juglindore, por në sektorë të veçantë shfaqen edhe ato veriperendimore. Gjatë periudhës gjysmë të ngrohtë mbizotërojnë erërat veriperendimore, fenomen që përkon edhe me qarkullimin brizor të kësaj periudhe. Një tjetër erë karakteristike e zonës në studim është murlani.

Cilësia e ajrit

Në afërsi të zonës ku gjendet instalimi nuk ka një stacion të monitorimit të parametrave që përcaktojnë cilësinë e ajrit dhe në këto kushte mungojnë të dhëna të sakta në lidhje me këtë aspekt. Por në arsyetim të përgjithshëm, zona është pjesë e një rajoni me urbanizim të vonë. Në këto kushte burimi kryesor i ndotjes së ajrit në zonë është trafiku i makinave dhe aktiviteti ndërtues. Instalimi ndodhet në një farë distance nga rruga rrugët kryesore, lokale dhe kombëtare, kështuqë ndikimi i trafikut në cilësinë e ajrit është përgjithësisht i pakët. Nga ana tjetër zona nuk karakterizohet nga zhvillime të mëdha industriale, për rrjedhojë cilësia e ajrit në zonë mendohet të jetë brenda standarteve të lejuara.

I njëjti arsyetim vlen edhe për nivelin e zhurmave në zonën në studim.

2.6 Karakteristikat socio-ekonomike

Administrativisht zona ku gjendet instalimi i përket Qarkut Tiranë, Bashkisë Kamëz, Njësisë administrative Kamëz, fshati Bathore. Bathorja shtrihet në një sipërfaqe prej 5 km² dhe deri në fillim të viteve '90 ka qenë një fermë shtetërore. Kjo zonë filloi të popullohej në fillim të viteve '90 me njerëz të ardhur nga zona veriore si Kukësi, Dibra, Tropoja, Puka dhe zona të tjera të afërta.

Bashkia Kamëz kufizohet në veri, lindje dhe jug me bashkinë Tiranë, në veri-perëndim me bashkinë Krujë dhe në perëndim me bashkinë Vorë. Kamza përbëhet nga dy njësi administrative, Kamza dhe Paskuqani.




Figura 12: Harta administrative e Bashkisë Kamëz

Sipas Censurit të vitit 2011 Bashkia Kamëz ka një popullsi prej 104,190 banorësh, ndërsa sipas regjistrit civil numëron 125,632 banorë. Ajo ka një sipërfaqe prej 37.18 km². Në bazë të censurit, densiteti i popullsisë është 2802 banorë për km² ndërsa sipas regjistrit civil, densiteti është 3379.02 banorë/km².

Kryeqendra e bashkisë së re është Kamza ndërsa ajo ka edhe 14 fshatra. Të dyja njësitë administrative janë pjesë e rrethit Tiranë, qarkut Tiranë.

Bashkia e re Kamëz është bashkia me sipërfaqen më të vogël dhe me densitetin më të lartë në Shqipëri, duke e bërë atë praktikisht bashkinë më urbane të Shqipërisë pavarësisht se përfshin nominalisht edhe 14 vendbanime që zyrtarisht janë fshatra.

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative sipas RAT	Qytetet dhe fshatrat nën juridiksionin e bashkisë	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrit Civil	Sipërfaqja km ²
Tiranë	Qyteti Kamëz	Kamëz	Qyteti Kamëz, fshatrat: Bathore, Laknas, Valias, Frutikulturë, Bulçesh, Zall-Mner	104,190	125,632	37.18
		Paskuqan	Fshatrat: Paskuqan, Babrru Qendër, Kodër e Kuqe, Shpat, Fushë e Kërçikve, Kodër Babrru, Paskuqan Fushë, Paskuqan Kodër			

Bashkia e re është ndërtuar gjatë 20 viteve të fundit kur rritja e popullsisë ka qenë në përmasa të jashtëzakonshme. Kamza si qendër e banuar numëronte më pak se 5 mijë banorë të përqendruar rreth ndërmarrjes bujqësore “Ylli i Kuq”, instituteve të teknologjisë bujqësore si dhe rreth minierës së qymyrit të Valiasit ndërsa popullsia u shtua me shpejtësi nga migrimi i brendshëm i popullsisë përgjatë 25 viteve të fundit. Kamza mori titullin e qytetit në vitin 1996 ndërsa Paskuqani, megjithëse zyrtarisht vijoi të klasikohej si zonë rurale, u bë efektivisht zonë urbane me një densitet të lartë të ndërtesave dhe popullsisë.

Kamza ka një sipërfaqe të punueshme prej 2,364 hektarë, shifër kjo e papërfillshme në krahasim me popullsinë, ndërkohë që pjesa më e madhe e tokës bujqësore është zënë nga banesat për shkak të ndërtimeve informale.

Popullsia e zbritur më së shumti nga zonat veriore dhe verilindore e vendit dhe ndërtimi i banesave të nevojshme për të strehuar këtë popullsi solli zhvillimin e industrisë së ndërtimit ndërsa një numër fabrikash të manufakturës u hapën në zonë ose në periferi të saj për të përdorur krahun e lirë të punës, veçanërisht të grave dhe vajzave.

Pjesa më e madhe e punëtorëve të Kamzës udhëtojnë çdo ditë për të punuar për arsim apo për qëllime të tjera në qytetin e Tiranës, tendencë kjo që është më e theksuar për zonën e Paskuqanit. Si një zonë e ndërtuar rishtas, Kamza dhe Paskuqani kanë probleme të shumta me ndërtimin e infrastrukturës publike urbane, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizime, e rrugë ndërsa popullimi i shpejtë ka krijuar nevojën për ndërtimin e më shumë shkollave dhe qendrave shëndetësore.

Investimet publike për urbanizimin e zonës kanë qenë të konsiderueshme gjatë viteve të fundit, por këto investime kanë krijuar njëkohësisht disnivele të lartë brenda bashkisë, ku disa zona janë të pajisura mirë me infrastrukturë ndërsa një pjesë e madhe nuk ka ende kurrfarë infrastrukture. Si një zonë e re urbane dhe me densitet të lartë të popullsisë, zhvillimi i infrastrukturës së duhur për ujësjellës, kanalizime, rrugë, sheshe publike apo parqe si dhe ndërtimi i shkollave, kopshteve, çerdheve e qendrave shëndetësore janë sdat kryesore të bashkisë së re.

Ndërtimi i shtëpive pa plan paraprak urban nënkupton gjithashtu mungesën e hapësirave të gjelbra publike apo të shesheve publike.

Por një problem i konsiderueshëm i banorëve të zonës është edhe mungesa e lidhjeve të përshtatshme të transportit publik me bashkinë Tiranë si dhe lidhjet e dobëta infrastrukturore me kryeqytetin. Fakti që Bashkia Kamzë është ndarje administrative më vete bën që banorët e kësaj bashkie të mos përfshihen në sistemin e aboneve të shërbimit urban të qytetit të Tiranës gjë që ka krijuar kosto të dyshme për udhëtime nga Kamza në Tiranë.

Shtimi i lidhjeve rrugore me Tiranën përmes ndërtimit të urave të reja si dhe krijimi i një sistemi të përbashkët të transportit publik me Tiranën kërkon bashkëpunim me autoritetet e bashkisë së Tiranës.

Bashkia e re numëron rreth 1200 biznese.

3 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS

3.1 Metodika e përdorur për vlerësimin e ndikimeve të mundshme në mjedis

Veprimtaritë që zhvillohet në mjedis shoqërohen edhe me ndikimet përkatëse në të që janë pjesë e pashmangshme e zhvillimit social dhe ekonomik. Është e detyrueshme që në përputhje me procedurat ligjore këto ndikime në mjedis të vlerësohen, diskutohen dhe të bëhen pjesë e procesit vendimarrës. Gjithashtu është e rëndësishme që të bëhen përpjekje të arsyeshme dhe të mundshme që pasojat në mjedis të ndikimeve të jenë sa më minimale dhe në përputhje me normat ligjore në fuqi. Vlerësimi i ndikimeve të mundshme si pasojë e veprimtarisë bëhet duke u nisur nga një sërë faktorësh që lidhen me natyrën e veprimtarisë, teknologjinë e përdorur për ndërtim, mënyrën e funksionimit, sasinë e energjisë, lëndët e para të përdorura dhe mbetjet e gjenerura, të gjitha këto në kontekstin e mjedisit fizik, biologjik dhe socio-ekonomik.

Bazuar në llojin e projektit të propozuar ndikimet e mundshme në mjedis mund dhe duhet të analizohen sipas fazave të aktivitetit të cilat mund të përfshijnë:

- fazën e ndërtimit,
- fazën e funksionimit,
- fazën e mbylljes së aktivitetit dhe rehabilitimit të mjedisit.

Me këtë përqaasje janë trajtuar në vijim ndikimet e mundshme të aktivitetit të propozuar si dhe masat për minimizimin e pasojave të tyre në mjedis dhe mbrojtjen e mjedisit.

3.2 Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedis

Aktiviteti “Prodhim i sistemit të plotë të instalimeve elektrike për automjete”, propozuar nga shoqëria Sews Cabind Albania Sh.p.k., do të zhvillohet në një instalim industrial të gatshëm të marrë në përdorim përkundrejt kontratës përkatëse me qira (referohu Shtojcës 2 të Raportit teknik). Në këto kushte, ndikimet e mundshme në mjedis të këtij aktiviteti do të shfaqen dhe analizohen vetëm për fazën e operimit. Në këtë fazë të projektit nuk ka akoma një afat kohor të përcaktuar në lidhje me jetëgjatësinë e aktivitetit. Për më tepër, edhe në rast të mbylljes së aktivitetit, kjo fazë do të përfshinte vetëm çmontimin dhe largimin e makinerive dhe paisjeve por jo prishjen e objekteve të instalimit.

Nga analiza e operacioneve të linjës së prodhimit të sistemeve të plotë të instalimeve elektrike për automjete vërehet se,

Teknologjia e prodhimit bazohet tërësisht në procese mekanike të cilat realizohen me makineri pneumatike të përmasave mesatare deri në të vogla të instaluara brenda kapanonit. Asnjë nga proceset e punës nuk karakterizohet nga çlirime të mundshme në ajër apo ujërash të ndotur industriale (kujtojmë që uji në instalim do të përdoret vetëm për pirje dhe qëllime sanitare) të cilat mund të përbëjnë shkakun kryesor për ndikime negative në mjedis si pasojë e aktivitetit. Gjithnjë në vijim të analizës së këtyre proceseve, evidentohet që ndikimi i vetëm në mjedis i aktivitetit do të jetë krijimi i mbetjeve.

3.2.1 Shkarkimet e mundshme në mjedis

Në fazën e operimit të instalimit shkarkimet në mjedis me ndikim të mundshëm në cilësinë e ajrit të zonës përfshijnë:

- Shkarkimet e gjeneratorit;
- Shkarkimet e automjeteve që do të transportojnë lëndën e parë dhe produktet.

Në këtë fazë të veprimtarisë, shoqëria akoma nuk ka përcaktuar tipin e gjeneratorit që do të instalohet në objekt por gjithsesi në procesin e përzgjedhjes do të mbahet parasysh që të përmbushë standartet mbi normat e lejuara të shkarkimeve. Në se do të vendoset jashtë kapanonit, do të shfrytëzohet hapsira në krah të kabinës elektrike e cila do të mbyllet për të shmangur zhurmat që çliron gjeneratori. Duhet vënë në dukje, se kjo hapsirë gjendet pranë kufirit verior të instalimit ku nuk ka banesa dhe as bimësi.

Sa lidhet me automjetet që do të transportojnë lëndën e parë dhe produktet, numri i tyre do të jetë i vogël dhe vlerësohet se zona ka kapacitete përthithëse për shkarkimet standarte të automjeteve. Për më tepër, lëndët e para dhe produktet nuk janë ndotëse dhe do të transportohen me automjete të mbyllur. Qoftë sheshi i instalimit qoftë rruga e aksesit janë të asfaltuar duke shmangur ngritjen e pluhurit.

Në këto kushte mund të konkludohet se ndikimi i shkarkimeve në ajër nga aktiviteti është *i papërfillshëm*.

Siç është treguar në raportin teknik dhe më lart në këtë dokument, teknologjia e prodhimit të sistemit elektrik për automjete bazohet në procese mekanike pa praninë e ujit. Për rrjedhojë, shkarkimet e

vetme të lëngëta janë ujërat e ndotur urbanë të cilat, nuk janë shkarkime nga procese teknologjike, por pasoja të veprimtarisë jetësore të personelit. Instalimi është i lidhur me rrjetin publik të mbledhjes së ujërave të zeza të zonës.

3.2.2 Prodhimi i mbetjeve

Mbetjet kryesore që do të krijohen nga procesi i prodhimit konsistojnë në materiale të riciklueshme, metal, ne forme teli dhe plastikë. Rrymat e tjera lidhen më së shumti me lëndët dhe paisjet ndihmëse në repartin e prodhimit dhe zyra.

Lëndët e para që përdor ky aktivitet janë në fakt produkte gjysëm të gatshme (kablo) të përbërë nga tel bakri dhe/ose alumini dhe veshje PVC. Mbetjet do të krijohen si rrjedhojë e procesit të prerjes së këtyre kabllove në gjatësinë e kërkuar dhe mbetjet e krijuara do të jenë metale (bakër, alumin) dhe veshje PVC.

Pjesë e proceseve të prodhimit është edhe printimi mbi kablo i informacionit të nevojshëm. Kjo do të realizohet me ndihmën e makinave të printimit me bojë. Si rezultat i këtij procesi do të krijohen mbetje të bojërave të printimit.

Në tabelën e mëposhtme janë treguar rrymat kryesore të mbetjeve të dala nga procesi i prodhimit dhe kodet përkatës sipas përcaktimeve të VKM nr.99 datë 18.02.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”.

Tabela 2: Rrymat kryesore të mbetjeve që dalin nga procesi i prodhimit

Nr.	Lloji	Kodi i mbetjes	Rryma e mbetjeve
1	Jo e rrezikshme	12 01 04	Pluhur dhe pjesë të imëta të metaleve joferrorë
2	Jo e rrezikshme	12 01 05	Mbetje plastike nga format dhe tornimet
3	Jo e rrezikshme	08 03 18	Mbetje nga bojë printi, të tjera nga ato të përmendura në 08 03 17
4	Jo e rrezikshme	15 01 09	Mbetje ambalazhi tekstili
5	E rrezikshme	15 01 10*	Kimikate të papërdorur, përfshirë ata të skaduar, mbetje kimikatesh/të lëngëta (materiale për pastrimin e ambientit, jo të përdorura në procesin e prodhimit)
6	Jo e rrezikshme	16 02	Mbetje nga pajisjet elektrike dhe elektronike
7	E rrezikshme	20 01 21*	Mbetje të tubave fluoreshente dhe mbetje të tjera që përmbajnë merkur. (mbetje nga sistemi i ndricimit të reparteve)
8	Jo e rrezikshme	20 01 36	Pajisjet e skaduar elektrike dhe elektronike

Sasia e parashikuar e mbetjeve do të jetë e vogël. Sipas planit të biznesit që ka bërë shoqëria, parashikohet që vetëm në vitin e parë të aktivitetit humbjet të jenë në masën 10% të prodhimit, kjo për arsye sepse pavarësisht trajnimeve të vazhdueshme, personelit do t’i duhet kohë të kualifikohet plotësisht për proceset përkatëse të punës. Në këto kushte, viti i parë i aktivitetit do të karakterizohet nga një sasi më e madhe produktesh difektoze, të cilat gjithashtu do të konsiderohen mbetje. Gjithnjë referuar planit të biznesit, për vitin e parë të aktivitetit vlerësohet se sasia e mbetjeve të bakrit do të jetë rreth 2 ton. Por duke nisur që nga viti i dytë, humbjet, pra mbetjet, do të jenë në masën 2% e prodhimit ose 1/5 e humbjeve të viti të parë, pra vetëm 400 kg bakër.

Gjithashtu gjatë aktivitetit do të krijohen sasi të vogla mbetjesh urbane, të ngurta dhe të lëngëta (ujëra të ndotur sanitarë) të cilat janë treguar në Tabelën 3.

Tabela 3: Rrymat kryesore të mbetjeve urbane që do të krijohen gjatë veprimtarisë

Lloji	Kodi i mbetjes	Rryma e mbetjeve
Jo e rrezikshme	20 01 01	Letër dhe karton
Jo e rrezikshme	20 01 02	Qelq
Jo e rrezikshme	20 03 01	Mbetjet e përziera urbane
Jo e rrezikshme	19 08 05	Ujëra të zeza (tualetet)

Menaxhimi i mbetjeve do të kryhet nga shoqëria sipas Planit të Menaxhimit të Mbetjeve i cili bazohet në 3 parimet bazë: Reduktim, Ripërdorim dhe Riciklim

3.3 Kohëzgjatja e mundshme e ndikimeve negative të identifikuar

Të gjitha ndikimet/shkarkimet e mundshme në mjedis të identifikuar në paragrafin e mësipër karakterizojnë fazën operacionale dhe për rrjedhojë do të zgjasin gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të aktivitetit.

3.4 Shtrirja e mundshme hapësinore e ndikimeve negative në mjedis

Siç është treguar në paragrafin 3.2 më lart, ndikimet e mundshme në mjedis të aktivitetit të propozuar përfshijnë shkarkime të mundshme minimale në ajër nga gjeneratori dhe nga qarkullimi i automjeteve të transportit të lëndës së parë dhe produktit të gatshëm. Zona e shtrirjes së këtyre shkarkimeve është ajo ngjitur me instalimin, për gjeneratorin, dhe përgjatë rrugës së aksesit për automjetet.

Sa lidhet me prodhimin e mbetjeve, ato krijohen dhe menaxhohen brenda instalimit.

3.5 Mundësia e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe kthimi në gjendjen e mëparshme

Është thënë që në fillim të këtij kapitulli që aktiviteti do të zhvillohet në një instalim të gatshëm të marrë makineritë dhe nëse veprimtaria do të mbyllet objekti do të mbetet siç është.

4 MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS

Për mënjanimin dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis të identifikuar në seksionin paraardhës, kompania do të hartojë dhe zbatojë me përpikmëri një Plan Masash për Mjedisin i cili ka për qëllim parandalimin ose minimizimin e ndotjes dhe dëmtimit të mjedisit si dhe shëndetin e sigurinë në punë.

Plani i masave synon respektimin e standardeve mjedisore gjatë gjithë ciklit të projektit në mënyrë të sigurt dhe efektive, me qëllim final mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit. Konkretisht, ai fokusohet në ndikimet e identifikuar në mjedis në fazat e ndërtimit dhe të shfytëzimit të veprës, si dhe masat përkatëse për shmangien dhe minimizimin e tyre. Plani mbështetet në parime të zbatueshme dhe praktika të njohura dhe pranuar për mbrojtjen e mjedisit.

Masat kryesore të propozuara në Planin e Menaxhimit të Mjedisit duhet të adresojnë zgjidhjet më optimale për minimizimin e ndikimeve negative të identifikuar në mjedis.

Për zbatimin e Planit të Menaxhimit të Mjedisit kompania do të trajtojë personelin e saj dhe do të mbajë komunikim të vazhdueshëm me ekspertë të fushës dhe specialistë të strukturave përgjegjëse për mjedisin.

Çdo punonjës gjatë kryerjes së operacioneve, duhet të jetë përgjegjës për respektimin e politikave, legjisllacionit, rregulloreve dhe standarteve përkatëse dhe, njëkohësisht, të zbatojë të gjitha procedurat e përshkruara në PMM.

Analiza e ndikimeve ka identifikuar si ndikimin kryesor të aktivitetit prodhimin e mbetjeve për menaxhimin e të cilave shoqëria do të hartojë dhe zbatojë një Plan të posaçëm.

4.1 Masat për Menaxhimin e Mbetjeve

Shoqëria e bazon menaxhimin e mbetjeve në 3 parimet bazë: Reduktim, Ripërdorim dhe Riciklim. Qëllimi i menaxhimit të mbetjeve është të organizojë menaxhimin e tyre që nga pika fillestare e prodhimit e deri në asgjësimin përfundimtar të tyre, në mënyrë që të zvogëlohet ndikimi i mundshëm në mjedis dhe dëmi në shëndetin e njerëzve. Rrymat e mbetjeve që prodhohen si rezultat i aktivitetit duhet të përcaktohen dhe trajtohen/asgjësohen në mënyrën e duhur. Për trajtimin e rrymave të ndryshme të mbetjeve shoqëria do të identifikojë kërkesat ligjore dhe subjektet e liçencuara për trajtimin e tyre.

Masat kryesore për kontrollin dhe menaxhimin e mbetjeve përfshijnë:

- **Mbetjet e riciklueshme** ku bëjnë pjesë mbetjet nga telat prej bakri dhe/ose alumini, veshtjet PVC, kartonat dhe ambalazhet e tjerë prej letre, plastikë, veshje tekstili, mbetje nga pajisje elektrike dhe elektronike, do të ruhen veçmas dhe do të dërgohen në kompani riciklimi. Materialet e riciklueshme që mund të kenë qenë në kontakt me substanca të rrezikshme si tretësit apo kimikate dhe që nuk mund të pastrohen do të trajtohen si mbetje të rrezikshme.
- **Mbetjet e rrezikshme** do të mblidhen dhe dorëzohen për trajtim nga kompani të liçensuara. Mbetjet e rrezikshme do të ruhen në vend të posaçëm, i cili me shumë gjasë do të jetë në hapsirën prapa kapanonit, ku do të jetë edhe magazina e ruajtjes së tyre. Vendi i ruajtjes së mbetjeve të rrezikshme do të pajiset me tabela sinjalizuese me të dhëna të detajuara për mbetjet e rrezikshme, të cilat do të vendosen në vende lehtësisht të dukshme. I gjithë personeli i autorizuar për të punuar me mbetjet e rrezikshme duhet të trajnohet për menaxhimin e duhur të tyre.
- **Mbetjet urbane** do të menaxhohen bazuar në kërkesat ligjore dhe standartet kombëtare dhe do të depozitohen në sistemin bashkiak (mbetjet urbane të përziera etj).. Në të gjithë instalimin do të vendosen kosha të ndarë për grumbullimin e diferencuar të tyre. Fraksionet e riciklueshme do të shkojnë për riciklim njësoj si edhe mbetjet nga aktiviteti. Pjesa e pandarë do të mblidhet në kontenier të veçantë. Për largimin e tyre do të kërkohet ofrimi i shërbimit publik që kryen mbledhjen dhe largimin e mbetjeve urbane në zonën ku ndodhet instalimi,
- Shoqëria zbaton politika mjaft rigorozë në drejtim të **reduktimit të plastikës**. P.sh. brenda mjediseve të instalimit është i ndaluar përdorimi i shisheve apo gotave plastike. Uji i pijshëm do të sigurohet nga rrjeti dhe përpara përdorimit do t'i nënshtrohet filtrimit. Secili punonjës do të ketë shishen individuale (e cila lahet) për konsumin e ujit në mënyrë që të shmanget përdorimin e shisheve dhe gotave plastike. Për kafe do të përdoren vetëm gota prej kartoni. Subjekti do të hartojë dhe zbatojë një plan të posaçëm menaxhimi të mbetjeve në objekt gjatë veprimtarisë së tij.

4.2 Masat e mbrojtjes ndaj zjarrit

Masat për mbrojtjen e mjedisit përfshijnë edhe Planin Përballimit të ngjarjeve të paplanifikuara (emergjencat) të cilat mund të shoqërohen me dëme dhe ndikime në mjedis.

Për aktivitetin në fjalë, ngjarje të tilla të paplanifikuara përfshijnë rënie e zjarrit. Në zbatim të legjislacionit në fuqi, shoqëria do të hartojë një Plan të mirëfilltë të veprimit në rast zjarri, plan i cili realizohet nga ekspertë të fushës dhe miratohet nga autoritetet përgjegjëse.

Masat kryesore të mbrojtjes nga zjarri përfshijnë:

- Instalimi i një sistemi për detektimin e tymit dhe zjarrit i cili do të sinjalizojë për të ndërhyrë në mënyrë manuale në kohën e duhur për shuarjen e zjarrit.
- Vendosja në instalim e pajisjeve të nevojshme për mbrojtjen ndaj zjarrit.
- Trajnimi i detyrueshëm i punonjësve për masat e shmangies dhe veprimit ndaj zjarrit.
- Afishimi i skemës së veprimit në rast zjarri.
- Afishimi i skemës së evakuimit në rast zjarri.
- Instalimi i mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike.

Konkretisht është kryer studimi dhe projekti përkatës i mbrojtjes kundra zjarrit. Me poshte janë vendosur disa skema (ne forma demonstrative) nga studimi dhe projektit prej 70 faqesh.

PROJEKTI I MBROJTJES DHE SHPETIMIT NGA ZJARRI

**OBJEKTI: SEWS-CABIND ALBANIA SH.P.K.
RRUGA ERZENI, BATHORE, KAMEZ (TIRANA), ALBANIA**

ADMINISTRATOR: MARIO SCARFALLOTO

 Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri
<https://mshz.al/>

EKSPERT I SIGURISE NGA ZJARRI

SAFETI DORRALLI
C/d. 4132, 4131, 4130, 4129
E-mail: s.bashaj@saferi.com

SKEMA E FIKRESJES TE ZJARRIT
SEWS-CABIND ALBANIA SH.P.K.
RRUGA ERZENI, BATHORE, KAMEZ (TIRANA), ALBANIA
PLANI KATI PERDHE




SH.P.JEGJIME TEKNIKE
KONSTRUKTIVE: SHUARJE E ZJARRIT ME PUNONJES
MARRËSHE: MARIO SCARFALLOTO
INVESTITOR: MARIO SCARFALLOTO




LEGJENDA

OBJEKTI: SEWS-CABIND ALBANIA SH.P.K.
EKSPERTET: SAFETI DORRALLI
MARRËSHE: MARIO SCARFALLOTO
INVESTITOR: MARIO SCARFALLOTO

SKEMA E EVAKUIMIT & EMERGJENCES
SEWS-CABIND ALBANIA SH.P.K.
RRUGA ERZENI, BATHORE, KAMEZ (TIRANA), ALBANIA
PLANI KATI PARE




SH.P.JEGJIME TEKNIKE
KONSTRUKTIVE: SHUARJE E ZJARRIT ME PUNONJES
MARRËSHE: MARIO SCARFALLOTO
INVESTITOR: MARIO SCARFALLOTO




LEGJENDA

OBJEKTI: SEWS-CABIND ALBANIA SH.P.K.
EKSPERTET: SAFETI DORRALLI
MARRËSHE: MARIO SCARFALLOTO
INVESTITOR: MARIO SCARFALLOTO

SKEMA E EVAKUIMIT & EMERGJENCES
SEWS-CABIND ALBANIA SH.P.K.
RRUGA ERZENI, BATHORE, KAMEZ (TIRANA), ALBANIA
PLANI KATI PERDHE



SH.P.JEGJIME TEKNIKE
KONSTRUKTIVE: SHUARJE E ZJARRIT ME PUNONJES
MARRËSHE: MARIO SCARFALLOTO
INVESTITOR: MARIO SCARFALLOTO



LEGJENDA

OBJEKTI: SEWS-CABIND ALBANIA SH.P.K.
EKSPERTET: SAFETI DORRALLI
MARRËSHE: MARIO SCARFALLOTO
INVESTITOR: MARIO SCARFALLOTO

Aktualisht instalimi është i pajisur me sistemin e mbrojtjes ndaj zjarrit (mjete dhe sinjalistikë).



Figura 13: Elementë të sistemit të mbrojtjes ndaj zjarrit, të vendosur në instalim



Figura 14: Pikë grumbullimi e personelit në rast evakuimi për shkak të zjarrit



Figura 15: Paisje e instaluar për mbrojtjen nga shkarkimet atmosferike